



---

# Protokoli i shkurtë i mbledhjes së Kuvendit të pestë të rregullt të BISHZ-së më 30.11.2002

---

**Vendi:** Hôtel Mandarin Oriental du Rhône, quai Th.-Turrettini, 1201 Genève/GE  
**Data:** E shtunë, 30 nëntor 2002 / 14.30 - 17.30  
**Protokoli:** Ahmet Xhigoli (sekretar)  
**Pjesëmarrës:** Ca. 30

---

## Pikat e rendit të ditës:

1. Hapja e Kuvendit dhe përshëndetja e të pranishmëve
  2. Paraqitja e raportit të punës së BISHZ-së për periudhën 12.01.02 - 29.11.02
  3. Vështrim i shkurtë i punës pesëvjeçare të BISHZ-së
  4. Ndarja e mirënjohjeve
  5. Iniciativa e BISHZ-së për themelimin e lobit ekonomik të shqiptarëve në Zvicër
  6. Të ndryshme
- 

## **1. Përshëndetja e të pranishmëve – hapja e Kuvendit**

Sipas rendit të ditës të përshkruar në ftesë, inxh. i dipl. Sinollah Shehu, nënkryetar, bëri hapjen e Kuvendit të pestë të rregullt dhe i përshëndeti të gjithë të pranishmit si dhe në veçanti musafirët Ambasadorin e Republikës së Shqipërisë pranë selisë së OKB në Gjenevë, Zotëri Vladimir Thanati; Zotëri Nazif Xhaferi, diplomat nga Maqedonia pranë selisë së OKB në Gjenevë; Zotëri Rexhep Rifati, gazetar për “Fakti” – n; Përfaqësues të shoqatave, bashkatdhetarë që e kanë ndihmuar shoqatën; anëtarë dhe udhëheqës të Shoqatës. Të ftuar ishin edhe ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Bern, Zotëri Leontier Quqi; sekretari i Ambasadës së Maqedonisë në Bern, Zotëri Leonard Marku; të cilët për shkaqe të arsyeshme nuk kanë mund të vijnë. Në vazhdim, z. Shehu lexoi rendin e ditës dhe e luti kryetarin e BISHZ-së, dr. Xhevat Salihu të bën paraqitjen e raportit të punës njëvjeçare të Shoqatës.



## 2. Raporti vjetor i BISHZ-së prej 12.01.2001 deri më 29.11.2002

Dokumenti "Raporti vjetor i BISHZ-së prej 12.01.2002 deri më 29.11.2002 u është shpërndarë të pranishëmve.

### *Aprovimi i raportit të punës për periudhën janar - nëntor 2002*

Dr. Xhevat Salihu përmes folive paraqiti raportin e aktivitetit të BISHZ-së për periudhën janar - nëntor 2002. Pas referimit të kryetarit, kishte pyetje nga më të ndryshmet, ndër të cilat edhe pse numri i anëtarëve dhe intelektualëve mbetet kaq i vogël. Përgjigje kishim mjaftë, por si duket arësyeja është se disa nga intelektualët tanë i peshojnë varshmëria, përçarjet, xhelozia, karrierizmi, interesi për përfitim personal, përtacia, oportunitizmi dhe plogështia mu në kohën kur duhet të jenë më të zgjuar, pastaj dhe marifetllëqet tjera që na rëndojnë nga koha më e herëshme, etj. Po ashtu kryetari, dha një sqarim që në bazë të të dhënave të një punimi që është bërë nga ai dhe ekipi i tij më 2000, ka ardhë në përfundim se Komuniteti shqiptar në Zvicër e zën vendin e fundit për sa i përket organizimit dhe integritimit në Zvicër. Në vazhdim zotëri Vladimir Thanati, Ambasadori i Republikës së Shqipërisë pranë selisë së OKB në Gjenevë, bëri një shprehje nga Vepra e Mit-hat Frashërit, me të cilën dëshmoi se vetëdija intelektuale tek shqiptarët nga ajo kohë e deri më sot ka lëvizur shumë pak. Në këtë pikë po ashtu në diskutime morrën pjesë edhe zotëri Imer Cacaj, zotëri Sinollah Shehu, zotëri Nazmi Jakurti, zotëri Nazif Xhaferi dhe zotëri Ahmet Xhigoli. Në përfundim të kësaj pike, raporti është aprovuar në tërësi.

## 3. Vështrim i shkurtë i punës pesëvjeçare të BISHZ-së

Në këtë pikë, zotëri A. Xhigoli, sekretar, së pari u shprehi përshëndetjet e sinqerta për pjesëmarrje me rastin e pesëvjetorit të Bashkimit të intelektualëve shqiptarë në Zvicër me seli në Bernë, të gjithë të pranishëmve. Më tutje ai theksoi që shkas i këtij solemniteti është jubileu i pesëvjetorit të punës së shoqatës Bashkimi i intelektualëve shqiptarë në Zvicër, e cila me sukses ka kryer një veprimtari të thuktë gjatë kësaj periudhe.

Në vazhdim, z. Xhigoli, shkurtimisht bëri një njoftim për rrugën e formimit të kësaj Shoqate dhe për rezultatet e punës gjatë kësaj periudhe sipas renditjes së dhënë më poshtë.

\*\*\*

Pas shumë përpjekjeve, para 5 vjetëve, më 29 nëntor 1997, arritëm që të tubojmë rreth 130 intelektualë shqiptarë që punojnë dhe jetojnë në Zvicër dhe të mbajmë Kuvendin e parë në hotelin Schweizerhof në Bernë, dhe të themelojmë shoqatën me emrin Bashkimi i intelektualëve shqiptarë në Zvicër. Në këtë Kuvend është definuar qëllimi i shoqatës dhe synimet e saj. Qëllimi është që të bashkoj potencialin intelektual shqiptar në Zvicër dhe atë ta vë në shërbim të çështjes kombëtare në përgjithësi dhe të komunitetit shqiptar në Zvicër, kusre synimet të sendërtohen nëpërmjet organizimit dhe zhvillimit të veprimtarive kulturore, projekteve profesionale e shkencore dhe tribunave të ndryshme. BISHZ-ja është një shoqatë. Në përbërje të vet ka një numër të konsiderueshëm të kuadrove profesionale nga lëmi të ndryshme. Veprimtaria e tij është e ndarë në 12 seksione: seksioni për shëndetësi, seksioni për teknikë, seksioni për çështje juridike, seksioni për ekonomi, seksioni për politikë, seksioni për çështje sociale, seksioni për informim, seksioni për kulturë, seksioni për sport, seksioni për arsim, seksioni për përkthime dhe seksioni për veprimtari botuese.

Për këto pesë vjet të kaluara, në këtë shoqatë janë bërë përpjekje dhe vetmohime të mëdha dhe janë arritur rezultate të konsiderueshme.

Sot me krenari mund të themi se gjatë këtyre 5 VJET PUNE, shoqata Bashkimi i intelektualëve shqiptarë në



Zvicër, me sukses ka zhvilluar në aktivitet të gjallë dhe ka realizuar në masë të madhe detyrat e parashtruara në programin e saj, ku shkurtimisht do ti përmendim disa prej tyre.

Prej themelimit e deri më tani, BISHZ-ja ka publikuar në rreth 30 deklarata dhe reagime qëndrimet e saja lidhur me zhvillimet në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, dhe në trevat tjera shqiptare, dhe po ashtu me vëmendje ka përcjellë dhe ka reaguar ndaj të gjitha shkrimeve të pavërteta lidhur me çështjen e Kosovës të paraqitura në mediat zvicerane. BISHZ-ja me qëndrimet e saja të njohura ka mbështetur moralisht dhe me mjete materiale dhe mjete të tjera Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe Popullin e Kosovës në luftën e zhvilluar kundër okupatorit serb. Lidhur me këtë, Shtabit të Emergjencës për Zvicër i'a ka vënë në dispozicion tri seksione: seksionin për përkthime, seksionin për shëndetësi dhe seksionin për teknikë (fusha e informatikës). Ka organizuar tre takime me përfaqësuesit e KNKK në Gjenevë për organizimin dhe ofrimin e ndihmave për Kosovë dhe dy takime me përfaqësuesit e Karitas-it, BFF, Kryqit të Kuq të Zvicrës. Ka organizuar grumbullimin dhe dërgimin e materialit mjekësor në Kosovë. Rreth njëzetë apele ua ka dërguar institucioneve botërore (OKB-së në Gjenevë, Qeverisë së Zvicrës në Bernë, Këshillit Europian në Strasburg, NATO-s në Bruksel), për ndaljen e menjëhershme të maskrave të bëra nga forcat serbe ndaj popullatës civile dhe të pa mbrojtur në Kosovë. Ka organizuar peticionin: "Mbështetje të fuqishme sulmeve ajrore të NATO-s kundër forcave ushtarake, policore dhe paramilitare të regjimit kriminal të Jugosllavisë" dhe i'a ka dërguar Javier Sollana në Bruksel. BISHZ-ja ka marrë pjesë në të gjitha protestat e organizuara në Zvicër për çështjen shqiptare. Ajo ka marrë pjesë në protesën e shqiptarëve në Rambuje të Francës. Po ashtu ajo ka qenë bashkëorganizatore e protestës në Gjenevë për lirin e pengjeve dhe të burgosëve shqiptarë në burgjet serbe. BISHZ po ashtu i ka shprehur ngushëllime të sinqerta Ambasadës Amerikane në Bernë për tragjedinë e 11 shtatorit 2001 në New York.

Në periudhën maj-tetor të këtij vit, BISHZ-ja ka mbështur të gjitha rezolutat e miratuara të Kuvendit të Kosovës.

Në fushën e kulturës dhe artit shqiptarë, BISHZ-ja, në bashkëpunim me Universitetin e Friburgut ka organizuar mbajtjen e tri ligjëratave për kulturë shqiptare, ka organizuar promovimin e tre librave të autorëve shqiptarë nga Zvicra, Kosova dhe Shqipëria, ka organizuar dy ekspozita të artit figurativ, ka organizuar ditët e filmit shqiptarë në Zvicër në tri qendra të mëdha në Zvicër me pjesëmarrjen e artistës Tinka Kurti.

Në fushën e sportit, në mars të vitit 1998, BISHZ-ja ka marrë pjesë në takime sportive në të cilat janë mbajtur garat për karate në Luzern të të gjitha shkollave të mesme në nivel të Zvicrës, ku në këto gara, shqiptarët kanë arritur dy fitore: vendin e dytë në kategorinë gjysëm të rëndë në karate, dhe vendin e tretë në kategorinë e rëndë të karates.

Gjatë kësaj periudhe, BISHZ-ja ka organizuar katër tibunat një në fushën e informimit me tutull: "Kosova dhe shqiptarët në mediat evropiane" dhe tre në fushën e shëndetësisë në temën SIDA.

Përveç këtyre veprimtarive të përmendura, BISHZ, me sukses ka kryer 5 projekte, një nga fusha e shëndetësisë, kurse katër nga fusha e Informatikës dhe ka nxjerrë numrin e parë të revistës Bashkimi - Revistë shkencore, kulturore, artistike dhe sportive.

Kur në këtë moment solemn flasim për këto rezultate, dëshiroj që ti falenderoj të gjithë ata të cilët në çfarëdo mënyre kanë dhënë ndihmesë në mbarëvajtjen e punës së BISHZ-së. Shfrytëzoj rastin që po ashtu të falënderoj ambasadorin zot. Vladimir Thanati për përkrahjen e dhënë deri më tani të mbarëvajtjes së BISHZ-së dhe shpersoj që një përkrahje të tillë do të kemi edhe nga ambasadori i ri të Republikës së Shqipërisë në Bernë, zot. Leontier Quqi. Po ashtu e falandëroj sekretarin e Ambasadës së Republikës së Republikës së Maqedonisë në Bernë zot. Halim Hyda për përkrahje të vazhdueshme të shoqatës tonë. Dhe në fund dëshiroj ti falenderoj gazetarët Rexhep Rifati dhe Nefail Maliqi për përkrahjen dhe afrimin e vlerave të BISHZ-së në mjetet e informimit dhe sekretarin Nazif Xhaferin i cili është prezent në këtë moment.

\*\*\*



## 6. Ndarja e mirënjohjeve

Në këtë pikë të rendit të ditës, kryetari, zotëri Salihu bëri ndarjen e tetë mirënjohjeve për intelektualët dhe veprimtarët të cilët e ndihmuan punën e Shoqatës dhe çështjen kombëtare në tërësi. Lista e personave të cilëve u është ndarë mirënjohje në këtë Kuvend solemn është:

1. Vladimir Thanati (ambasador i Shqipërisë pranë Misionit të OKB-së në Gjenevë)
2. Halim Hyda (sekretar Ambasadës së Maqedonisë në Bernë)
3. Leonard Marku (sekretar pranë Ambasadës së Maqedonisë në Bernë)
4. Rexhep Reifati (gazetar në Fakti)
5. Nefail Maliqi (gazetar në Bota Sot)
6. Imer Cacaj (këshilltar)
7. Enver Pula (këshilltar)
8. Llokman Beqiri (administrator)

*Për secilin kandidat, kryetari z. Salihu para të pranishmëve e ka bërë leximin e përmbajtjes së mirënjohjeve.*

## 5. Iniciativa e BISHZ-së për themelimin e lobit ekonomik të shqiptarëve në Zvicër,

Në këtë pikë, zotëri I. Cacaj, këshilltar i BISHZ-së, shprehi mendimin se në Kosovë është koha të investohet, dhe këtë punë duhet ta bëjmë pikërisht ne shqiptarët. Ai foli për projektin e themelimit të një organizate bankiare të tipit Bankë Off Shore në një zonë neutrale të Botës, e cila do të bashkon shumë akcionar.

Në vazhdim, z. Cacaj dha edhe një agjendë kohore të aktivitetit të mëtejshëm për këtë çështje për periudhën janar-shkurt 2003, ku si termin të fundit e paraqiti themelimin dhe regjistrimin e kësaj banke deri në fund të muajit shkurt të vitit 2003. Pas kësaj paraqitje u shtruan shumë pyetje nga të pranishmit dhe po ashtu nga z. Cacaj u dha përgjigjeje dha sqarim në pyetjet e shtruara.

## 6. Të ndryshme

Pasi që nën pikën e rendit të ditës “të ndryshme“ nuk pati ndonjë pikë konkrete, nënkryetari, z. Shehu e mbylli këtë Kuvend duke i ftuar të pranishmit në një koktej të cilin e organizoi kryesia e BISHZ-së.

**Mbledhja e Kuvendit zgjati prej orës 14:30 deri në ora 17:30**



## **BISHZ - VAIS - UIAS**

BASHKIMI I INTELKTUALËVE SHQIPTARË NË ZVICËR  
VEREINIGUNG DER ALBANISCHEN INTELKTUELLEN IN DER SCHWEIZ  
UNION DES INTELECTUELS ALBANAIS EN SUISSE  
UNIONE INTELLETTUALI ALBANESI IN SVIZZERA

---

\*\*\*

### **Njoftim dhe sqarim:**

Gjatë kohës së koktejit, në bazë të disa anëtarëve të cilët me vëmendje e kanë përcjellur zvillimin e shumë bisedave të këndshme dhe atmosferën festive kemi marrë komplimente që organizimi i Kuvendit të pestë është bërë në nivel të shkëlqyeshëm. Për këtë organizim, kësaj radhe, meritat më të mëdha i takojnë zotëri Imer Cacaj. **Imer për anagazhimin tënd të dhënë për këtë Kuvend të falenderojmë shumë!**

\*\*\*

Bellach, 17 dhjetor 2002

Udhëhqësi i protokolit,  
Dr.sc. Ahmet Xhigoli, sekretar